



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 360, Datë 30.12.2022

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SE FILLUAR ME VENDIMIN ERE NR. 112 , DATË 19.05.2022 MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC - I TËRVOLIT” SH.P.K., “PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET SHOQËRISË FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË (FTL) SH.A. DHE SHOQËRISË “HEC - I TËRVOLIT” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20 gërma “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 23, pika 12 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 03.09.2016; Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016 dhe “Kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.06.2016, të ndryshuar; Vendimit të bordit të ERE-s nr. 112, datë 19.05.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec - i Tërvolit” sh.p.k për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë (FTL) sh.a. dhe Shoqërisë “Hec - i Tërvolit sh.p.k.”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 2129/2 prot., datë 29.12.2022,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 112 , datë 19.05.2022 mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Hec - i Tërvolit” sh.p.k., duke vendosur:
 1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Hec- i Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Hec- i Tërvolit” sh.p.k. dhe shoqërisë “FTL” sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016.
- Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e

gjendjes së emergjencës ne furnizimin me energjie elektrike”, të ndryshuar ndër të tjera vendosi:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë”, sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike te shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë”, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr.687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, qe do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.”, dhe

2. Në pikën 5, fjalët 31 dhjetor 2022, “zëvendësohen me 30 qershor 2023”.

- Sikurse evidentuar më sipër, është vendosur Detyrimi i Shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë”, sh.a., dhe në pikën 2 është përcaktuar vijimi i gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, deri në datën 30 Qershor 2023.
- Meqënëse “Hec - i Tërvolit” sh.p.k., ka nënshkruar me shoqërinë FTL sh.a., Kontratën për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të bordit të ERE-s, të ndryshuar bazuar në VKM-në nr.650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energjie elektrike”, të ndryshuar, aplikohet vendosja e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë”, sh.a.
- Këtyre prodhuesve përshirë dhe shoqërinë “Hec - i Tërvolit” sh.p.k., i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike te shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë se miratuar me Vendimin nr.687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, qe do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, e cila zgjat deri më 30 qershor 2023”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurës se filluar me vendimin e bordit të ERE nr. 112 , datë 19.05.2022 kërkesën e shoqërisë “Hec - i Tërvolit” sh.p.k., është shprehur “Për zgjidhjen e

mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të lirë (FTL) sh.a. dhe Shoqërisë “Hec - i Tërvolit” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI